

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/dy-fjale-te-fundit-per-histerine-folklorike-kunder-ngritjes-se-muzeut-i586274
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:26:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	97af8c8a36df5acc80c74cbb6da0288854f78c186c4bb62311fd3b6331c693c9
TEKSTI	89b9011af84bbed1fd5f2497bb80e5d785c67bba689305be041665725e809862
PAMJA	a3bffa4dc48c4540643cc20343c979dc4e3e830198c31365b0f9dcf7b45ff9dea

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e385f7d005449b948fa1e63436d1186e6682520836a2b179f45eb5af45bc82a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e385f7d005449b948fa1e63436d1186e6682520836a2b179f45eb5af45bc82a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)

English

ie [Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë](#) [Mbrotjtja zbulon faturen, 42 mije euro ne gjashte muaj per çdo ushtarak ne Gaza](#) [U ar fundit](#)

Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë



15 Shtator 2026, 15:25 Blog Nga Ardi Stefa

Publikova një shkrim për ngritjen e Muzeut Hebraik në Vlorë dhe nga patriotët folkloristë e konspiracionistë të Facebook-ut filluan pyetjet retorike dhe argumentet kundër ngritjes së tij.

Komentuesit ose nuk e kishin lexuar, ose nuk e kishin kuptuar shkrimin.

Gjithsesi njëri nga argumentet ishte: “Ne i shpëtuam hebrejntë, prandaj ata duhet të ndërtojnë një muze për Vlorën në Tel Aviv!”.

Por ky argument duket logjik vetëm nëse një muze e trajtojmë si faturë mirënjohjeje.

Historia nuk funksionon kështu.

Ne nuk kemi pse të ndërtojmë një muze hebraik në Vlorë sepse “ua kemi borxh” hebrejve, dhe hebrejntë nuk kanë pse të ndërtojnë një muze të Vlorës në Tel Aviv sepse “na e kanë borxh”. Një muze nuk është shpërblim, dëmshpërblim apo kthim borxhi. Është kujtesë.

Nëse një familje vlonjate fshehu një familje hebreje gjatë Holokaustit, ajo histori është edhe histori e hebrejve, edhe histori e asaj familjeje shqiptare, edhe histori e Vlorës.

Yad Vashem dokumenton konkretisht raste të tilla në Vlorë, ndërsa familje shqiptare u njohën për shpëtimin e hebrejve.

Pyetja e drejtë që shtrohet në këtë rast nuk është: “Kush duhet t’i jetë mirënjohës kujt?”, por: “A duam ta ruajmë këtë histori apo jo?”

Dhe nëse përgjigjja është po, atëherë një muze hebraik në Vlorë ka kuptim pikërisht sepse tregon një kapitull të historisë së Vlorës: praninë hebraike, bashkëjetesën, persekutimin nazist dhe mënyrën se si shqiptarët, në rrethana ekstreme, mbrojtën njerëz që rrezikonin jetën.

Një muze i tillë nuk do të ishte vetëm “Muze Hebraik”. Do të ishte edhe një muze i Vlorës, sepse do të tregonte se çfarë bënë vlonjatët kur historia i vuri përballë zgjedhjes më të vështirë: të dorëzonin njeriun apo ta mbronin.

Sa për pretendimin se hebrejntë kanë qenë në Shqipëri prej shekujsh, ai nuk duhet as të pranohet verbërisht, as të hidhet poshtë me një “nuk është e vërtetë”. Ka dëshmi për prani hebraike shumë më të hershme se Lufta e Dytë Botërore.

Për Vlorën, burimet e Yad Vashem përmendin një traditë sipas së cilës hebrej në Vlorë, Berat e Elbasan jetonin në Shqipëri që nga rreth viti 1490, ndërsa disa kishin ardhur nga Janina.

Pra, një muze serioz duhet të bëjë pikërisht këtë: të ndajë faktin nga legjenda, dokumentin nga folklori dhe historinë nga propaganda.

Lini një Përgjigje

Koment *

[S'është puna se duan 10 mijë euro, por se sillen si pronarë të shtetit](#)

11:37 Blog

Darka e Lucës

09:35 Blog / 44 komente

Ku banojnë 4.28 milionë shtetasit shqiptarë që kanë lindur në Shqipëri?

17:52 Blog / 19 komente

Ç'punë ka Garda e Republikës të ruajë një gjykatë?!

12:40 Blog / 17 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.